


Statistika të Kulturës, 2024

Tiranë, më 20 Qershor 2025

- Gjatë vitit 2024, janë organizuar gjithsej 1.282 shfaqje dhe premiera në institucionet qendrore të artit, duke shënuar një rritje prej 9,1 %, krahasuar me 2023.
- Gjatë vitit 2024, numri i vizitorëve në institucionet e trashëgimisë materiale është 1.314.999 vizitorë, 30.7 % më shumë, krahasuar me 2023.
 - Gjatë vitit 2024, numri i vizitorëve të huaj është 788.270 vizitorë, të cilët përbëjnë 59,9 % të numrit gjithsej të vizitorëve në institucionet e trashëgimisë materiale.
- Në vitin akademik 2024-25, në fushat e studimit të lidhura me kulturën janë regjistruar 16.645 studentë, 1,4 % më pak studentë, krahasuar me vitin e kaluar akademik.
- Në fushat e studimit të lidhura me kulturën për vitin akademik 2024-25, fushat më të preferuara nga studentët e arsimit të lartë janë:
 - Arkitekturë dhe ndërtim me 6.246 studentë;
 - Gjuhët e cila renditet e dyta me 3,381 studentë, ndjekur nga fusha e studimit Sporte me 2.990 studentë dhe Arte me 2.288 studentë;
 - Shkenca humane përfshijnë 1,228 studentë, ndërsa Gazetaria dhe Informimi ka 512 studentë.
- Në vitin akademik 2024-25, në arsimin e lartë janë regjistruar 2.253 studentë të huaj, 1,7 % më pak, krahasuar me vitin e kaluar akademik.
 - Shumica e studentëve vijnë nga Italia (1.162 studentë) dhe nga Kosova (392 studentë).
- Në 2024, shpenzimet publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare përbëjnë 1,56 % të shpenzimeve publike gjithsej dhe zënë një peshë prej 0,45 % në PBB-në gjithsej.


Trashëgimia kulturore

- Gjatë vitit 2024, numri i vizitorëve në institucionet e trashëgimisë materiale është:
 - 468.839 në muze, 19,7% më shumë, krahasuar me vitin e kaluar,
 - 344.785 në kala e monumente të tjera, rritur me 27,0%, krahasuar me 2023,
 - 501.375 në parqet arkeologjike, 46,2% më shumë, krahasuar me vitin e kaluar.

Fig.1 Përqindja e vizitorëve të huaj dhe vendas në muze, kala dhe monumente të tjera, parqe arkeologjike, 2024

Burimi: Ministria e së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, INSTAT

- Nga totali i vizitorëve vendas dhe të huaj, institucionet e trashëgimisë materiale më të frekuentuara janë paraqitur në figurën 2.


Fig.2 Pesë institucionet e trashëgimisë materiale më të frekuentuara, 2024

Burimi: Ministria e së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, INSTAT

Arsimi kulturor

- Në vitin akademik 2024-25, në fushat e studimit të lidhura me kulturën, numri i femrave të regjistruara është 9.377, duke shënuar një rënie me 4,0 %, krahasuar me vitin e kaluar akademik.
- Femrat përbëjnë shumicën e studentëve të regjistruar, me 56,3 % të totalit të regjistrimeve për këtë vit akademik.

Fig.3 Përqindja e studentëve të regjistruar në fushat e kulturës sipas gjinisë, 2024-25



Burimi: Ministria e Arsimit dhe Sportit, INSTAT

Lëvizshmëria e të nxënësve në arsimin e lartë

Studimi jashtë vendit të origjinës u ofron studentëve mundësinë të përjetojnë sistemin tonë arsimor dhe të njohin dhe zbulojnë kulturën e vendit tonë, si vend pritës.

- Në vitin akademik 2024-25, në arsimin e lartë janë regjistruar 2.253 studentë të huaj, 1,7 % më pak, krahasuar me vitin e kaluar akademik. Sipas nivele arsimore, shpërndarja e studentëve të huaj është:
 - 0,4 % në programet dy vjeçare të arsimit të lartë;
 - 30,4 % në programet bachelor;
 - 64,8 % në master;
 - 4,4 % në programet doktoraturë.

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit në Shërbime dhe Mallra Kulturorë


- Krahasuar me vitin e kaluar, ndryshimi vjetor në përqindje i indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore është:

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>

- Instrumenta muzikorë- rritje me 8,5 %;
- Libra- rritje me 5,1 %;
- Shërbime kulturore- rritje me 1,3 %;
- Gazeta dhe mjete shkollore – rritje me 0,8 %;
- Pasisje audio-vizuale, fotografike dhe riparimi i tyre- ulje me 1,5 %.

Fig.4 Indeksi i harmonizuar i çmimeve të konsumit për disa mallra dhe shërbime kulturore, 2024

Viti bazë: Dhjetor 2015 =100




Burimi: Anketa e Çmimeve të Konsumit, llogaritjet INSTAT

Shpenzimet Publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare

- Në vitin 2024, shpenzimet publike për Argëtim, Kulturë dhe Çështje Fetare në raport me PBB dhe në raport me shpenzimet totale kanë shënuar (fig.5):
 - një rënie prej 0,05 pikë përqindje si përqindje ndaj PBB-së, krahasuar me 2023,
 - një rënie prej 0,19 pikë përqindje, si përqindje ndaj totalit të shpenzimeve publike, krahasuar me 2023.

Fig.5 Shpenzimet publike për argëtim, kulturë dhe çështje fetare, (në %)



Burimi: Ministria e Financave, llogaritjet INSTAT (* Të dhënat janë gjysëm-finale ** Të dhënat janë bazuar në vlerësimet tremujore)

Për t'u konsultuar me botime të tjera, vizitoni faqen e INSTAT: <http://www.instat.gov.al/>

Metodologjia

Statistikat e paraqitura në këtë publikim janë siguruar nga anketat që INSTAT zhvillon dhe nga burimet administrative si Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit dhe Sportit si dhe Ministria e Financës. Metodologjia e përdorur bazohet në rekomandimet e Eurostat.

Trashëgimia kulturore dhe pjesëmarrja kulturore

Të dhënat mbi trashëgiminë kulturore dhe pjesëmarrjen kulturore i referohen vetëm institucioneve, të cilat janë në varësi të Ministrisë së Kulturës. Në institucionet qendrore të artit e të kulturës përfshihen: Teatri Kombëtar, Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Teatri Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli", Qendra Kombëtare Kulturore për Fëmijë dhe Cirkul Kombëtar. Në totalin e muzeve, kalave dhe parqeve arkeologjike janë përfshirë institucionet:

Muze	Kala e monumente të tjerë	Park arkeologjik
Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë	Kalaja Berat	Parku Kombëtar, Butrint
Muzeu Arkeologjik, Durrës	Kalaja Gjirokastrë	Parku Arkeologjik, Apolloni
Muzeu i Pavarësisë, Vlorë	Kalaja e Portopalmos	Parku Arkeologjik, Bylis
Muzeu Gjergj Kastrioti, Krujë	Kalaja e Kaninës	Parku Arkeologjik, Shkodër
Muzeu Etnografik, Krujë	Kalaja e Himarës	Parku Arkeologjik, Lezhë
Muzeu Etnografik, Berat	Amfiteatri	Parku Arkeologjik, Amantia
Muzeu Ikonografik Onufri, Berat	Manastiri i 40 Shenjtorëve	Parku Arkeologjik, Orikum
Muzeu i Artit Mesjetar, Korçë		Parku Arkeologjik, Finiq
Muzeu Arkeologjik, Korçë		Parku Arkeologjik, Antigona
Muzeu i Arsimit, Korçë		
Muzeu Kombëtar i Fotografisë Marubi		
Muzeu Kombëtar i përgjimeve "Shtëpia me Gjethe"		

Arsimi kulturor

Të dhënat mbi regjistrimet e studentëve në arsimin e lartë në fusha studimi të lidhura me kulturën janë siguruar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Bazuar në klasifikimin e fushave të studimit (ISCED-F 2013), fushat që konsiderohen të lidhura me kulturën janë:

Fushat në kulturë
021 Arte
022 Shkenca humane
023 Gjuhët
032 Gazetari dhe informim
073 Arkitekturë dhe ndërtim
Sporte

Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit

Të dhënat mbi indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit lidhur me mallrat dhe shërbimet kulturore janë siguruar nëpërmjet anketës të Çmimeve të Konsumit, që INSTAT zhvillon me periodicitet mujor. Ky tregues bazohet në Klasifikimin Evropian të Shpenzimeve Individuale sipas Qëllimit (ECOICOP) me 12 ndarje kryesore.

ECOICOP – qëllime kulturore
CP091 Pajisje audio-vizuale, fotografike dhe riparimi i tyre
CP09221 Instrumenta muzikore
CP0942 Shërbime kulturore
CP0951 Libra
CP0952 Gazeta, dhe mjete shkollore

Përkufizime

Trashëgimia kulturore është tërësia e pasurive kulturore, materiale dhe jomateriale, të një individi, grupi ose shoqërie të trashëguara nga e kaluara që ruhen në të tashmen, për t'ua përçuar brezave në të ardhmen, si pjesë e pasurisë kombëtare të një vendi, të cilat shprehin vlerat, identitetin, njohuritë, traditat, besimet si dhe pasuritë kulturore.

Muze është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

Monument kulture është objekti ose ndërtimi me vlera historiko-kulturore, që mbrohet nga shteti.

Park arkeologjik është territori i përcaktuar me kufij të qartë, që përfshin dëshmi të rëndësishme arkeologjike të mbitokës, nëntokës e nënujit dhe bashkëprani të pasurive historike, peizazhit kulturor, i organizuar me elemente të një muzeu në natyrë.

Programe dy vjeçare të arsimit të lartë janë programe studimi me karakter profesional pas arsimit të mesëm, me 60 ose 120 kredite formimi, referuar nivelit 5- Arsimit të lartë, cikël i shkurtër, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Kohëzgjatja e tyre normale është një ose dy vite akademike dhe në përfundim lëshohet respektivisht "Certifikatë".